



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2019:142353
Datë: 19.05.2022
Numri i dokumentit: 03029907

Ac.nr.1390/2020

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Lumni Sallauka - kryetar i kolegjit, Hunaida Pasuli dhe Ardian Ajvazi - anëtarë të kolegjit, në çështjen juridike kontestimore të paditësve V.B, O.B, A.B, A.B, F.B, R.B, dhe F.B, të gjithë me vendbanim në Prizren, rr.”.....” nr., të cilët i përfaqëson av. A.R nga Prizreni, kundër të paditurës B.K.S, me seli në Prishtinë, rr.”.....”, pa.nr, me objekt të padisë kompensimin e dëmit material në emër të rentës mujore, duke vendosur sipas ankesës së të paditurës, të ushtruar kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prizren, C.nr.1138/14, të datës 17.09.2019, në seancën e kolegjit të mbajtur më **04.05.2022**, mori këtë:

A K T G J Y K I M

I. REFUZOHET si e pathemeltë ankesa e të paditurës B.K.S, me seli në Prishtinë, ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prizren, C.nr.1138/14, i datës 17.09.2019, në pikën I dhe III të dispozitivit, **VËRTETOHET**.

II. Pika II e dispozitivit të aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prizren, C.nr.1138/14, të datës 17.09.2019, mbetet e pashqyrtuar.

A r s y e t i m

Gjykata e shkallës së parë, me aktgjykimin e ankimuar C.nr. 1138/14, të datës 17.09.2019, në pikën I të dispozitivit e ka aprovuar kërkesëpadinë e paditësve V.B, O.B, A.B, dhe A.B, ashtu që ka detyruar të paditurën B.K.S, me seli në Prishtinë që paditësve V.B (bashkëshortja), O.B, A.B, A.B (fëmijët), në emër të kompensimit të dëmit fitimin e humbur (rentën mujore) të kapitalizuar për periudhën 06.05.2014 deri më 30.04.2018 shumën prej 31.749,93 € në të cilën shumë është llogaritur dhe kamatë ligjore prej 8 % nga dita e parashtrimit të padisë në gjykatë më datë 26.12.2014 e deri më 09.01.2018 (kur është përpiluar

ekspertiza), si dhe fitimit të humbur (rentës mujore) ti paguajë secili paditës veç e veç shumën prej 147,00 € apo shumën në tërësi prej 588,00 €, e cila do të llogaritet nga 01.05.2018, me kamatë ligjore prej 8 % deri sa paditësit e mitur (O, A, A.B) të arrijnë moshën madhore (18 vjet), ndërsa paditësja V.B, moshën e pensionimit (65 vjet) e cila shumë do të paguhet çdo fillim të muaji deri më datë 05 deri sa të ekzistojnë kushtet ligjore të gjitha këto në afat prej 15 ditësh pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit nën kërcënimin e dhunshëm. Në pikën II të dispozitivit gjykata ka konstatuar se padia e paditësve V, O, A, An, F,R dhe F.B lidhur me dhimbjet shpirtërore ,shpenzimet e varrimit dhe të ngrijtës së lapidarit për të ndjerin P.B është tërhequr. Ndërsa në pikën III të dispozitivit ka detyruar të paditurën që ti bart shpenzimet e procedurës, ashtu që detyrohet që paditësve t'ia paguaj shpenzimet në shumë prej 4,450.00 €.

Kundër këtij aktgjykimi, brenda afatit ligjor ka paraqitur ankesë pala e paditur, për shkak të shkeljes se dispozitive te procedurës kontestimore, konstatim të gabuar apo jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatim të gabuar të së drejtës materiale, me të cilën i ka propozuar Gjykatës se Apelit që të aprovoj ankesën e te paditurës dhe të prishë aktgjykimin e shkallës së parë dhe shumat e gjykuara t'i gjykojë dukshëm më të ulta duke pasur parasysh të gjitha pretendimet ankimore, apo çështja të kthehet në rigjykim dhe në rivendosje.

Paditësit kanë parashtruar përgjigje në ankesë dhe i ka propozuar Gjykatës së Apelit që ankesën e të paditurës të refuzoj si të pa bazuar, ndërsa aktgjykimin e shkallës së parë ta vërtetoj.

Gjykata e Apelit e Kosovës pasi që i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktgjykimin e atakuar dhe pretendimet ankimore, e pas vlerësimit të tyre, në kuptim të neneve 194 dhe 195.1, pika (d), lidhur me nenin 200, të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK) dhe gjeti se:

-Ankesa e paditurës është e **pathemeltë**.

Nga shkresat e lëndës rezulton se paditësit me padinë e parashtruar më datën 22.12.2014, e të precizuar në gjykatën e shkallës së parë, kanë kërkuar që si pasojë e aksidentit të komunikacionit të datës 06.05.2014, e paditura të kompensoi dëmi material, përkatësisht rentën mujore në emër të mbajtjes së humbur, me kamatë vjetore prej 8 % në vit, nga dita e ushtrimit të padisë e gjerë në pagesën përfundimtare në afatin prej 15 ditësh nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi, nën kërcënim të ekzekutimit të dhunshëm si dhe shpenzimet e procedurë së kontestimore (më gjerësisht sikurse në precizimin e kërkesëpadisë së paditësve).

Gjykata e shkallës së parë duke vepruar sipas padisë së paditësve, pas shqyrtimit dhe administrimit të provave të paraqitura nga palët ndërgjyqëse si në vijim: kallëzimi penal i datës 14.05.2014, raporti të aksidentit 2014-TR-0055n i datës 06.05.2014, certifikata e vdekjes së të ndjerit P.B e datës 26.05.2014, certifikata e martesës, ekstraktet e lindjes së V, A, A, O.B, deklaratën e bashkësisë familjare numër rendor 20/20001/1 kontrata e punës e lidhur ndërmjet P.B dhe firmës “.....”, nga Gjermania së bashku me listën e pagave, kërkesa për kompensimin e dëmit material dhe jo material e datës 2306.2016, kërkesa për rentë e datës 26.06.2014, raporti mjeko-ligjor psikiatrik të Dr. N.F të datës 12.08.2016, ekspertiza e ekspertit aktuar A.B e datës 01.07.2016, super ekspertizës financiare e datës 09.01.2018, dhe (*prova të*

tjera si në shkresat e lëndës), ka nxjerrë aktgjykimin e atakuar C.nr.1138/2014, të datës 17.09.2019, me të cilën e ka aprovuar në tërësi si të bazuar kërkesëpadinë e paditësve.

Në arsyetim të aktgjykimit të atakuar, gjykata e shkallës së parë, pas administrimit të provave mes tjerash, ka theksuar se nuk ka qenë kontestuese se i ndjeri P.B këtu bashkëshorti dhe prindi i paditësve në aksidentin e datës 06.05.2014, ka ndërruar jetë, ku shkaktar i aksidentit ka qenë M.G, i cili me aktgjykim penal është shpallur përgjegjës, gjithashtu nuk është kontestues fakti se këtu paditësit janë bashkëshortja dhe fëmijët e mitur të cilët fakte vërtetohen nga certifikatat e lindjes, vdekjes dhe deklaratat e bashkësisë familjare dhe se gjatë kohës së aksidentit i njëjti ka qenë në marrëdhënie pune në Gjermani, por për gjykatën ka mbetur kontestues fakti respektivisht lartësia e fitimit të humbur-rentës e cila i përket paditësve për periudhën e ardhshme kohore nga data e shkakimit të aksidentit dhe periudhën e ardhshme kohore deri sa të ekzistojnë rrethanat respektivisht kushtet ligjore, andaj në këtë drejtim gjykata ka nxjerrë ekspertizë akuaristike-financiare, super ekspertizës, përmes së cilave e ka caktuar rentën mujore. Kështu, në mbështetje të dispozitave të neneve 178 dhe 382 të LMD-së lidhur me nenin 143 të LPK-së, vendosi si në dispozitiv të aktgjykimit të atakuar, ndërsa vendimin mbi shpenzimet procedurale e mori duke u mbështetur në nenin 452 të LPK-së. *(më gjerësisht sikurse në arsyetim të aktgjykimit të atakuar).*

Nisur nga kjo gjendje e çështjes, Gjykata e Apelit vlerëson së qëndrimi dhe përfundimi juridik i gjykatës së shkallës së parë është i drejtë dhe i ligjshëm, pasi që aktgjykimi i atakuar nuk është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pika (b), (g), (j), (k) dhe (m) i LPK-së dhe se e drejta materiale është zbatuar në mënyrë të drejtë, për të cilat shkaqe Gjykata e Apelit kujdeset sipas detyrës zyrtare në kuptim të dispozitës së nenit 194 të LPK-së, e po ashtu ky aktgjykim nuk është i përfshirë as në shkelje tjera të dispozitave të procedurës kontestimore të cilat i ka pretenduar pala ankuese me ankesë.

Nuk qëndrojnë pretendimet ankimore të palës së paditur për shkeljet që i referohen konstatimit të gabuar të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, e as shkeljeve të tjera nga neni 182.2, pasi që arsyetimi i aktgjykimit është në përputhje me dispozitën e nenit 160, par. 4 dhe 5 të LPK-së, meqë gjykata e shkallës së parë, ka dhënë arsye të mjaftueshme për faktet e çështjes, për provat që i ka shfrytëzuar për vërtetimin e fakteve dhe vlerësimin e tyre. Sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit, dispozitivi i aktgjykimit të atakuar është mjaft i qartë, e në përputhje të plotë me arsyet e aktgjykimit, duke bërë kështu që dispozitivi dhe arsyetimi, si dy pjesë përbërëse të aktgjykimit, të jenë në harmoni logjike dhe juridike me njëra tjetrën. Gjykata e shkallës së parë ka arsyetuar të gjitha faktet me peshë vendimtare për themelësinë e kërkesëpadisë, e në lidhshmëri me këtë ka arsyetuar mënyrën se si janë vërtetuar faktet, e gjithashtu edhe mënyrën se si i ka vlerësuar provat për secilin fakt të provuar. Në këtë kontest, në arsyetim të aktgjykimit janë dhënë arsye të duhura për mënyrën e vërtetimit të fakteve, për provat e administruara dhe për vlerësimin e tyre sa i përket besueshmërisë dhe fuqisë provuese të tyre. Gjykata e shkallës së parë i ka arsyetuar të gjitha rrethanat me peshë përcaktuese duke filluar nga përgjegjësia e të paditurës për kompensimin e demit *(baza juridike e kërkesëpadisë nuk ishte kontestuese për palët ndërgjyqëse, ndërsa pala paditur ka dhënë edhe ofertë pales paditëse për zgjidhjen e këtij kontesti me marrëveshje),*

pastaj rrethanat që lidhen me kategorinë e dëmit dhe rrjedhimisht përfundimin për vëllimin e kërkesës së aprovuar. Për këto arsye, refuzohen si të pabazuara pretendimet ankimore sipas të cilave gjykata e shkallës së parë ka bërë shkelje të tilla, me rastin e hartimit të vendimit gjyqësor.

Sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit, gjykata e shkallës së parë me të drejtë i është referuar dispozitës 178 të LMD-së, e cila rregullon të drejtën e personit të cilin e ka ushqyer personi që i është shkaktuar vdekja par.1 përcakton: *“Personi, të cilin e ka ushqyer ose e ka ndihmuar rregullisht personi që i është shkaktuar vdekja si dhe ai që sipas ligjit ka pasur të drejtë të kërkojë ushqim nga personi, të cilit i është shkaktuar vdekja ka të drejtë të shpërblimit të dëmit që pëson nga humbja e ushqimit ose e ndihmës”*, ndërsa par.2 i këtij neni përcakton se: *“Ky dëm shpërblehet me pagimin e rentës në të holla, shuma e së cilës caktohet duke marrë parasysh të gjitha rrethanat e rastiit, e që nuk mund të jetë më e madhe nga ajo që do të fitonte i dëmtuari nga personi të cilit i është shkaktuar vdekja po të mbetet gjallë”*. Po ashtu në bazë të provave të administruara gjykata, ka vërtetuar faktin se paditësit janë trashëgimtar ligjor në shkallë të parë të ndjerit P.B, andaj edhe sipas dispozitës 172 të LMD-së, kanë të drejtën e kompensimit të dëmit- mbajtjes së humbur për shkak të vdekjes së bashkëshortit-babait të tyre P.B.

Sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit, gjykata e shkallës së parë i ka arsyetuar të gjitha faktet me peshë vendimtare për themelësinë e kërkesëpadisë së paditësve, andaj edhe e konsideron si të drejtë dhe të ligjshëm aktgjykimin e atakuar, që ka të bëjë me dëmin material për fitimin e humbur, si dhe rentën në të ardhmen. Kjo për faktin se referuar ekspertizës financiare të grupit të ekspertëve (datë 09.01.2018), është vërtetuar se ekspertët pas analizës së shkresave në lëndë kanë llogaritur fitimin e humbur-rentën për familjarët e të ndjerit për periudhën e kaluar nga data e aksidentit 06.05.2014 e deri më datë 30.04.2018 arrin vlerën në 27.968,15 €, të cilës kur ti shtohet kamata ligjore prej 4.451,44 € arrin shumën prej 32.419,54 €, si dhe për të ardhmen derisa të ekzistojnë kushtet ligjore në shumë mujore nga 147 euro për secilin paditës. Andaj, gjykata e shkallës së parë sa i përket lartësisë së dëmit për këtë formë të dëmit material me të drejtë vendimin e ka mbështetur në ekspertizën dhe plotësimin e saj të grupit të ekspertëve, si dhe ekspertizën financiare të aktuaristikës, të cilat janë të pranueshme edhe për gjykatën e shkallës së dytë. Në lidhje me këtë, përmes kësaj ekspertize të grupit të ekspertëve (edhe plotësimin të saj), si dhe ekspertizës financiare, në mënyrë të argumentuar janë caktuar shumat sa i përket dëmit material për fitimin e humbur dhe rentës në të ardhmen, e cila do të ishte satisfakcion moral që ka të bëjë më tepër me mbajtjen e familjes, veshmbathjes, ushqimin dhe çështjet e tjera të jetesës gjatë periudhës që konsiderohet që i ndjeri kishte mundur të punoj, ngase i njëjti ka qenë në marrëdhënie pune në shtetin e Gjermanisë, gjë që gjykata e shkallës së parë e ka vërtetuar edhe përmes kontratës së punës dhe të ardhurat nga pagat të cilat i ka realizuar i ndjeri para aksidentit. Në ekspertizat përkatëse janë dhënë shpjegime dhe arsyetime të plota edhe për të gjitha pretendimet e palës së paditur, të përsëritura edhe në ankesë, që kanë të bëjnë me punësimin e paditëses së parë dhe shfrytëzimit të ndihmës sociale, të cilat edhe janë përfshirë në llogaritjen e lartësisë së kërkesëpadisë. Si rezultat i kësaj, edhe pretendimet ankimore të palës së paditur lidhur me çështjet e cekura më lartë, rezultuan si të pabazuara.

Gjykata e Apelit e pranon si të drejtë qëndrimin juridik të gjykatës së shkallës së parë për sa i përket vendimit për shpenzimet e procedurës, pasi që të njëjtat janë gjykuar në përputhje me nenin 452.1 të LPK-së, lidhur me TA-në, si dhe vendimin lidhur me kamatën ligjore të cilën e ka bazuar në nenin 382 të LMD-së.

Gjykata e Apelit i vlerësoi edhe të gjitha pretendimet e tjera ankimore, por të njëjtat nuk ishin me ndikim për një vendim ndryshe, për çka vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Gjykata e Apelit ka vendosur sikurse në pikën II të dispozitivit të këtij aktgjykimi, pasi ka rezultuar se anjëra palë ndërgjyqëse nuk ka parashtruar ankesë ndaj pikës II të dispozitivit të aktgjykimit të atakuar, për çka edhe kjo pjesë konform nenit 194 të LPK-së, ka mbetur e pashqyrtuar.

Nga arsyet e cekura më lartë, Gjykatës së Apelit i rezultoi se gjykata e shkallës së parë në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme ka vendosur në këtë çështje juridike, andaj në mbështetje të dispozitave nga neni 194 dhe 195 paragrafi 1 pika (d), lidhur me nenin 200 të LPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E ,KOSOVËS NË PRISHTINË
Ac.nr.1390/2020, datë 04.05.2022

Kryetari i kolegjit,
Lumni Sallauka